



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1363 Prot.

Tiranë, më 02.07.2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 48 Datë 02.07 2026

**“PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT
"MASTER I SHKENCAVE" NË "SHKENCAT SPORTIVE" NË FAKULTETIN E
SHKENCAVE TË LËVIZJES" DHE UNIVERSITETIT "CARLO BO" TË
URBINOS NË ITALI”**

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në LAL në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, vendimin nr.310 datë 11.05.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 7, 43, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 24 të Rregullores së UST-së, Vendimin Qarkullues të Rektoratit nr.88 datë 01.07.2026, shkresën e Ministrisë së Arsimit nr.5049 Prot., datë 30.06.2026 "Njoftim mbi vlerësimin e aplikimeve", shkresën nr. 39/8 prot., datë 01.07.2026 të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes "Përcjellje për miratim të Rregullores së programit të studimit "Master i Shkencave" në "Shkenca Sportive", Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik nr. 97 dt 01.07.2026, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 02.07.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit "Master i Shkencave" në "Shkenca Sportive".
2. Programi i përbashkët i studimit do të zhvillohet në gjuhën angleze.
3. Kodi i programit të përbashkët të studimit është P72MS1014A (shkresa bashkëlidhur)

4. Efektet financiare që burojnë nga kjo marrëveshje do të miratohen në buxhetin e çdo viti.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

